

VENDIM
Nr. 34, datë 13.6.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:
Bashkim Dedjakryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 18.2.2016, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 1 Akti, që u përket:

KËRKUES: Grigor Mulla

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Shoqëria tregtare “Grumbullim-përpunim drithi” sh.a., Bashkia Korçë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 1820, datë 19.7.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr. 172, datë 7.3.2012, të Gjykatës së Apelit Korçë; nr. 00–2015–365, datë 17.2.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 28, 29 dhe 30, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 718, datë 3.4.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, është vendosur detyrimi i shoqërisë “Grumbullim-Përpunim Drithi” sh.a., që të paguajë në favor të kërkuarit Grigor Mulla dhe bashkëpronarëve të tjerë të ish-shoqërisë “General Electric” një shumë prej 11.281.644 lekësh, që përfaqëson vlerën e përdorimit në keqbesim të disa objekteve nga ana e kësaj shoqërie, njëkohësisht dhe lirimin dhe dorëzimin e disa objekteve të specifikuar në dispozitivin e këtij vendimi.

2. Kërkuari Grigor Mulla, në cilësinë e aksionarit të ish-shoqërisë “General Elektrik Korçë”, i është drejtuar juridiksionit të zakon-shëm për prishjen e shoqërisë tregtare “Grumbullim Përpunim Drithi” sh.a., e cila rezultonte debitore ndaj aksionerëve të shoqërisë së sipërcituar, dhe caktimin e një likuiduesi për të bërë likuidimin e zakonshtëm në gjendjen e aftësisë paguese të saj.

3. Me vendimin nr. 1820, datë 19.7.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pambështetur në ligj e prova.

4. Me vendimin nr. 172, datë 7.3.2012, Gjykata e Apelit Korçë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të sipërcituar.

5. Me vendimin nr. 00–2015–365, datë 17.2.2015, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuari Grigor Mulla, me arsyetimin se shkaqet e paraqitura në rekurs nuk përmbushin kriteret e parashikuara nga ligji,

konkretisht neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

II

6. **Kërkuesi Grigor Mulla** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të të tria shkallëve të gjykimit, me pretendimin se i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime:

6.1 Duke vlerësuar se zgjidhja e çështjes objekt gjykimi nuk mund të bëhet nëpërmjet gjykatës, kjo e fundit i ka mohuar kërkuesit të drejtën për një gjykim të drejtë, në bazë të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

6.2 Konfuziteti i shprehur në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe mos-dhënia e një zgjidhjeje nga ana e gjykatës, përbën një tjetër aspekt të cenimit të procesit të rregullt ligjor.

6.3 Vendimi i Gjykatës së Apelit Korçë është i paarsyetuar, pasi kufizohet vetëm në përshkrimin e rrethanave të çështjes. Ai nuk ka analizuar kundërshtitë e ngritura para kësaj gjykate, duke përbërë kështu një shkallë gjykimi të munguar dhe të privuar.

6.4 Edhe vendimi i Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar. Kjo gjykatë duke mos e pranuar rekursin ka legjitimuar shkeljet e kryera në shkallët e tjera të gjykimit.

6.5 Në rastin konkret rezulton i plotësuar kushti për prishjen e shoqërisë, sipas pikës “ç” të nenit 187 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Përveç plotësimit të këtij kushti, vetë pika “d” e po këtij neni përcakton qartë se shoqëria mund të priset me vendim gjykate.

7. **Subjektet e interesuara**, shoqëria tregtare “Grumbullim-Përpunim Drithi” sh.a. dhe Bashkia Korçë, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim para Gjykatës lidhur me pretendimet e ngritura në kërkesë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

9. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, sipas neneve 131/f, 134/1/g dhe 134/2 të Kushtetutës, individët kanë legjitimitet të kushte-zuar, për arsye se mund t’i drejtohen Gjykatës vetëm për pretendime të lidhura me procesin e rregullt ligjor, pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Po ashtu, kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizu-ar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*shih vendimin nr. 3, datë 19.2.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto standarde, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit në thelb kanë të bëjnë me cenimin e parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor në këndvështrim të respektimit të së drejtës së aksesit të tij në gjykatë. Për pasojë, këto pretendime *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar dhe të së drejtës së aksesit në gjykatë

10. Kërkuesi pretendon se gjykatat e faktit, duke vlerësuar se zgjidhja e çështjes objekt gjykimi nuk mund të bëhet nëpërmjet tyre, i kanë mohuar të drejtën për një gjykim të drejtë. Sipas tij, vendimet janë të paarsyetuara, konfuze dhe nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura nga kërkuesi. I paarsyetuar është edhe vendimi i Gjykatës së Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit, duke legjitimuar shkeljet e kryera në shkallët e tjera të gjykimit. Sipas

kërkuesit, në rastin konkret plotësohen kushtet për t'iu drejtuar Gjykatës në kuptim të nenit 187 të ligjit nr. 9901/2008, "Për tregtarët dhe shoqë-ritë tregtare".

11. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundër-shtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Respektimi i kërkesës për arsyetimin e vendimeve gjyqësore, penale apo civile, është një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive (*shih vendimet nr. 27, datë 22.5.2015; nr. 8, datë 16.3.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre, në përputhje me standardet e zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese (*shih vendimin nr. 12, datë 19.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Sidoqoftë, detyrimi për arsyetimin e vendimit gjyqësor nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 28, datë 28.5.2015; nr. 36, datë 26.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave (*shih vendimin nr. 62, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, e drejta për të pasur një vendim të arsyetuar nga gjykata është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me të drejtën për akses në gjykatë, e cila përfshin të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare për pretendimet e ngritura para saj.

14. Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse vendimi gjyqësor plotëson ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht formal. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 28, datë 22.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Duke i vlerësuar pretendimet e kërkuesit në këndvështrim të respektimit të standardeve të mësipërme, Gjykata vlerëson se ato nuk janë të bazuara. Referuar vendimeve gjyqësore të kundërshtuara rezulton se kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesë për prishjen e shoqërisë "Grumbullim-Përpunim Drithi" sh.a. dhe caktimin e likuiduesit me qëllim likuidimin e kreditorëve të kësaj shoqëria, ku njëri prej të cilëve është edhe ish-shoqëria "General Elektrik Korçë", aksioner i së cilës është edhe kërkuesi. Duke qenë se kjo shoqëri kishte 2 vjet që nuk kryente veprimtari tregtare dhe vetë ishte në pamundësi për të caktuar likuidues, pasi nuk funksiononte asambleja e përgjithshme për të marrë një vendim të tillë, kërkuesi i është drejtuar gjykatës në bazë të nenit 187 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në mënyrë që t'i hapë rruga likuidimit për përmbushjen e detyrimeve të shoqërisë si palë debitore.

16. Pasi kanë marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në kërkesëpadi, provat e paraqitura

dhe prapësimet e palëve, në përfundim të gjykimit gjykatat kanë vlerësuar se kreditori nuk është një nga subjektet që parashikon ligji nr. 9901/2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” që mund të kërkojë prishjen dhe likuidimin shoqërisë. Për pasojë, në rastin konkret gjykatat kanë respektuar kërkesat për të pasur një vendim të arsyetuar. Vendimet gjyqësore të kundër-shtuara përmbajnë një analizë të hollësishme të ligjit të zbatueshëm, si dhe argumentet se përse kërkuesi nuk mund t’i drejtohet gjykatës me një kërkesë të tillë. Edhe në këndvështrim të së drejtës së aksesit, gjykatat i kanë dhënë kërkuessit një zgjidhje për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, duke e orientuar edhe për të drejtat që i njihen atij si kreditor në këtë proces.

17. Në lidhje me procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, bazuar në veçoritë e gjykimit në atë Gjykatë, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se arsyetimi i kufizuar i vendimit të marrë në dhomën e këshillimit nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimin nr. 27, datë 22.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Vetëm kur konstatohen shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar dhe riparuar nga Gjykata e Lartë, vendimi për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 6, datë 10.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Për sa kohë që Gjykata nuk ka konstatuar shkelje në ndonjë nga elementet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në gjykimin e zhvilluar në gjykatat e faktit, edhe vendimi i Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e rekursit si të pabazuar në dispozitat procedurale, nuk paraqet probleme kushtetushmërie.

19. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e ngritura në kërkesë janë të pabazuara dhe ajo duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Gani Dizdari, Fatos Lulo, Gani Dizdari

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në çështjen me kërkuess Grigor Mullën, si dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice.

2. Kërkuesi ka pretenduar cenim të së drejtës së aksesit, pasi gjykatat nuk i kanë dhënë zgjidhje mosmarrëveshjes së themelit dhe nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura prej tij në padi. Kështu, duke u shprehur se “*roli për zgjidhjen e situatës nuk mund t’i kalojë atyre*”, gjykatat e zakonshme kanë cenuar procesin e rregullt ligjor. Edhe vendimi i Gjykatës së Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit, ka legjitimuar, sipas kërkuessit, shkeljet e kryera në shkallët e tjera të gjykimit.

3. Nëpërmjet arsyetimit të saj shumica ka pohuar se “vendimet gjyqësore të kundërshtuara përmbajnë një analizë të hollësishme të ligjit të zbatueshëm, si dhe argumentet se përse kërkuesi nuk mund t’i drejtohet gjykatës me një kërkesë të tillë. Edhe në këndvështrim të së drejtës së

aksesit, gjykatat i kanë dhënë kërkuessit një zgjidhje për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, duke e orientuar edhe për të drejtat që i njihen atij si kreditor në këtë proces. Për sa kohë që Gjykata nuk ka konstatuar shkelje në ndonjë nga elementet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në gjykimin e zhvilluar në gjykatat e faktit, edhe vendimi i Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e rekursit si të pabazuar në dispozitat procedurale, nuk paraqet probleme kushtetutshmërie” (shih §16 dhe § 18 të vendimit).

4. Nuk pajtohem me këtë përfundim të shumicës për arsyet në vijim.

5. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila do t’i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Ajo ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë, për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Në këtë kuptim, ky standard përfshin të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, për çështjet civile, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit në një organ gjyqësor duhet të jetë një e drejtë që lidhet me themelin dhe jo një e drejtë e pastër formale. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) (shih vendimet nr. 2, datë 29.1.2016; nr. 22, datë 16.4.2014; nr. 7, datë 27.2.2013; nr. 14, datë 26.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese).

6. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) është shprehur se neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së i siguron çdokujt të drejtën për të pretenduar të drejtat dhe detyrimet civile para një gjykate ose tribunali. Në këtë kuptim, ky standard përfshin të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të filluar një proces para gjykatave për çështje civile, përbën një aspekt të saj. E drejta për t’iu drejtuar gjykatës nuk ka karakter absolut; ajo mund të ketë kufizime, por ato nuk duhet të kufizojnë hapësirën e aksesit për individin në një mënyrë të tillë sa e drejta të preket në thelbin e saj (*Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere, vendim i 23 qershor 1981; Sporrong dhe Lönnroth, vendim i 23 shtator 1982*).

7. Nga aktet që ndodhen në dosjen gjyqësore rezulton se me vendimin nr. 718, datë 3.4.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është vendosur detyrimi i shoqërisë “Grumbullim Përpunim Drithi” sh.a. që të paguajë në favor të kërkuessit Grigor Mulla dhe bashkëpronarëve të tjerë të ish-shoqërisë “General Electric” një shumë prej 11.281.644 lekësh, që përfaqëson vlerën e përdorimit në keqbesim të disa objekteve nga ana e kësaj shoqërie, njëkohësisht edhe lirimimin dhe dorëzimin e disa objekteve të specifikuara në dispozitivin e këtij vendimi. Ky vendim është ekzekutuar vetëm për sa i përket lirimimit dhe dorëzimit të disa objekteve dhe jo për vlerën monetare të sipërcituar. Për këtë arsye, kërkuessi, pasi ka ndjekur të gjitha rrugët procedurale për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, por pa arritur të realizojë të drejtën e tij të fituar me vendim gjyqësor, i është drejtuar gjykatës për zgjidhjen e këtij konflikti. Ky kërkim është rrëzuar nga gjykatat nëpërmjet vendimeve objekt shqyrtimi në këtë çështje.

8. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm janë shprehur se “pavarësisht se problemi i kësaj shoqërie është futur në një ngërç ku asnjë organ nuk pranon të marrë përsipër përgjegjësitë, roli për rregullimin e një situate të tillë nuk mund t’i kalojë gjykatës, përderisa në asnjë dispozitë ligjore nuk përcaktohet një gjë e tillë [...]” (shih vendimin nr. 1820, datë 19.7.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë).

9. Në vlerësimin tonë, nëpërmjet këtij arsyetimi jo të plotë dhe të dykuptimshëm, që lë të nënkuptohet se kërkuessi nuk ka një bazë ligjore ku mund ta mbështesë padinë e tij, gjykatat, pavarësisht se pranojnë të drejtën legjitime të kërkuessit që buron nga vendimi gjyqësor i formës së prerë, kanë vënë në diskutim të drejtën e tij për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje për themelin e pretendimeve. Lidhur me të drejtën e aksesit, e gjykojmë të rëndësishme të sjellim në vëmendje parashikimin e nenit 1 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), sipas të cilit “gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për

shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë”.

10. Bazuar në këtë dispozitë, si dhe në jurisprudencën kushtetuese, gjykata duhet të kërkojë gjithmonë brenda rendit juridik në fuqi normën që rregullon dhe zgjidh një mosmarrëveshje konkrete. Në rast se një normë e tillë nuk ekziston, ajo duhet të kërkojë norma të tjera që rregullojnë rastet analoge. Gjkata, për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, ka detyrën funksionale për të kryer interpretime të ndryshme në lidhje me kuptimin e normave, me kërkimin e normave që rregullojnë rastet analoge apo me identifikimin e parimeve të përgjithshme dhe të jurisprudencës kushtetuese (*shih vendimin nr. 28, datë 16.12.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Këto të meta të evidentuara nuk janë korrigjuar as nga Gjykata e Apelit, që ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, as nga Gjykata e Lartë, që ka vendosur në dhomë këshillimi mospranimin e rekursit pa i dhënë përgjigje kërkuesit për pretendimin e tij. Në jurisprudencën e saj konstante Gjykata ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e kësaj Gjykate i kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (*shih vendimet nr. 52, datë 2.12.2013; nr. 36, datë 25.7.2013; nr. 58, datë 24.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto kushte vlerësojmë se Gjykata e Lartë ka lejuar zhvillimin e një procesi të parregullt ligjor.

12. Si përfundim, për sa më lart, ndryshe nga shumica, çmojmë se në rastin konkret është cenuar e drejta e aksesit në Gjykatën e Lartë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, ndaj kërkesa e paraqitur nga kërkuesi duhet të ishte pranuar.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi